



UDHËZUES PRAKTIK PËR SEANCAT ONLINE TË KOMISIONIT DISIPLINOR NDAJ PËRMBARUESVE

Për të përcaktuar përgjegjësinë disiplinore të përmbaruesit privat, Komisioni Disiplinor mban seancë dëgjimore të cilat si rregull janë të hapura për publikun dhe mbahen në Ministrinë e Drejtësisë. Si pasojë e situatës së krijuar nga COVID-19, Komisioni Disiplinor me propozimin e palëve dhe/ose pajtimin e tyre, mund të mbajë seancat dëgjimore edhe online.

SI MBAHEN SEANCAT ONLINE?



Së pari, caktohet data e seancës disiplinore nga Komisioni.



Pastaj kontaktoheni nga Ministria e Drejtësisë përmes telefonit ose e-mailit për datën dhe kohën e mbajtjes së seancës.

- Ju do të njoftoheni se mund të kërkonti dhe/ose pajtoheni që seanca të mbahet online.
- Ju do të pranoni të gjitha informacionet e duhura që përfshinë

- linkun dhe emrin unik të seancës.
- Sigurohuni që Ministria e ka email adresën tuaj aktive dhe numrin e telefonit si dhe të njejtat i kontrolloni rregullisht.



Seancat e Komisionit Disiplinor mbahen përmes platformës www.jitsi.org



Para fillimit të seancës vizitoni uebfaqen www.jitsi.org.

Pasi të shtypni butonin “start a meeting” shkruani emrin unik të cilin e keni pranuar paraprakisht dhe filloni takimin përmes butonit

Emrat e seancave i gjeni edhe në tabelën e seancave të publikuar në faqën zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, në linkun: <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,45#c97>



Para se të fillojë seanca, sigurohuni që jeni të kyçur në internet dhe keni një kamerë dhe mikrofon të lidhur me kompjuterin ose telefonin tuaj.

Kyçuni me herët në seancë në mënyrë që të shmangen vonesat dhe seanca të fillojë në kohën e caktuar.



Sigurohuni që e keni letërnjoftimin afër ose e dërgoni të skenuar në e-mailin që e keni pranuar ftesën.



Nëse keni ndonjë dokument që dëshironi ta dorëzoni, ju duhet paraprakisht të konsultoheni me Ministrinë e Drejtësisë ose Komisionin se si do ta bëni dorëzimin.



Nëse keni nevojë për përkthyes apo interpret për të akomoduar dëgjimin tuaj, ju duhet të njoftoni Ministrinë e Drejtësisë paraprakisht.